



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:041182

Datë: 10.08.2022

Numri i dokumentit: 03316178

P. nr.1016/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. Apër shkak të veprave penale, **Rrezikim i trafikut publik**, nga neni **370 paragrafi 9 lidhur me par.1 dhe 6** të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm PP. II nr. 632/2013, të datës 30.04.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 28.07.2022, sipas vërejteve të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, mori dhe në prezencë të palëve, shpalli, ndërsa, më dt. 10.08.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B.A**, nga babai I. dhe nëna R., e lindur S., i lindur me datë ... në fsh., K. e Gjilanit, jeton në rr. i martuar, baba i pesë fëmijëve, bagerist, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar edhe më parë dhe nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datë 05.04.2013, rreth orës 19:35 minuta, në Gjilan, në rr. ... afër automekanikut “...”, nga pakujdesia, duke shkelur nenin 54.1 të Ligjit për sigurinë e komunikacionit në rrugë, që ka të bëjë me përshtatjen e shpejtësisë së automjetit kushteve të rrugë, duke pasur parasysh pamjen, kushtet dhe dukshmërinë e rrugës, kushtet atmosferike, në mënyrë që automjeti të ndalet para çdo pengese, ka rrezikuar jetën e njerëzve, në atë mënyrë që drejtuar veturën e markës “...”, prodhim i viotit 2003, ngjyrë hiri dhe numër të shasisë ... të pa regjistruar, në rrugën kah drejtimi i fabrikës së B..., në drejtim të Prishtinës, nuk e ka vërejtur këmbësorin, tani të ndjerin A. J.viktimën dhe me pasqyrën e djathtë të kësaj veture, e ka goditur të dëmtuarin, i cili në pamundësi të shmangjes, është përplasur me kokë në pjesën e djathtë të parafangos, pastaj, ka rënë në tokë dhe nga këto goditje, i janë shkaktuar plagë vdekjeprurëse në formë të hematomeve në kokë, frontal, perietal djathtas, gjakderdhje në gojë dhe rugëve të frymëmarrjes, nga të cilat i njëjti ka vdekur në vend të ngjarjes, fakt ky i konfirmuar edhe me

raportin mjeksor të Qendrës Emrgjente të Spitalit Regjional të Gjilanit, me nr. ..., të dt. 05.04.2013 dhe ekspertizës mjeko-ligjore të dt. 09.04.2013,

-me çka ka kryer veprën penale, **Rrezikimi i trafikut publik**, nga **neni 378 par 9 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së**, andaj, Gjykata, bazuar në dispozitat e neneve 7, 17, 23, 42, 69, 107 të KPRK-së dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së,

E GJYKON

Të akuzuarin B.A me Dënim me Burg, në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve** në bazë të nenit 72 par.1.5 të KPRK, ashtu që, në mbështetje të **nenit 44 të KPRK-së**, me pëlqimin e të akuzuarit, dënimi i shqiptuar me burg, **do t'i zëvendësohet në Dënim Gjobë**, në shumë prej **2500 (dy mijë e pesëqind) €**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

I mundësohet të akuzuarit që dënimin e përmendur ta paguajë në 5 (pesë) këste

Në bazë të nenit 39 par. 4 nënpar. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të akuzuarit i shqiptohet taksa në shumën prej **30 (tridhjetë) €**.

Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej **20 (njëzet) €**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzën PP. II nr. 632/2013, të datës 30.04.2013, kundër të akuzuarit B.A, për veprën penale, Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim merititor sipas ligjit.

Gjyqtarja e çështjes, më dt. 09.06.2021 ka marrë aktgjykim dënues për të akuzuarin, duke ia shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajsh dhe duke ia zëvendësuar atë dënim me dënim gjobe në shumën prej 1500 €.Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesa kanë ushtruar Prokuroria Theemelore në Gjilan, Përfaqësuesi i palve të dëmtuara, R. e M. jashari, av. Mustafë Nuiu, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe të akuzuarit t'i shqiptojë dënim më të lartë dhe tae me burgim efektiv.

Më datën 28.10.2021, Gjykata e Apelit e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

Sipas udhëzimeve të Gjyaktës së Apelit, gjyqtarja e çështjes e caktoi sencën gjyqësore për dt. 28.07.2022, me ç'rast, në këtë seancë të pranishëm ishin, prokurororja e shtetit, Kujtesa Fazliu, i akuzuari B.A dhe i dëmtuari R. J, ku i akuzuari B.A e pranoi fajsisë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Meqenëse i akuzuari B.A e ka pranuar fajsinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i cili pranim është bërë pa presion, pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me pasojat dhe benefitet e

pranimi të fajsisë, i cili pranim është në përputhshmëri me të gjitha provt materiale dhe personale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si, Aktvendimi për fillimin e hetimeve, dt. 06.04.2013, Aktvendimi mbi caktimin e paraburgimit i dt. 06.04.2013, procverbali nga vendi i ngjarjes, i dt. 05.04.2013, deklaratat e e dëshmitarëve-dëmtuarve dhënë në polici dhe prokurori, Raporti i Spitalit Rajonal në Gjilan-Emergjenc me nr. ... i dt. 05.04.2013, mendimi e ekspertit mjeko-ligjori dt. 09.04.2013, ekspertiza mbi aksidentin e komunikacionit, e dt. 30.04.2013, raporti shtesë nr.... ..., i dt. 08.04.2013, foto-dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, si dhe Super-Expertiza e dt. 18.02.2017, e hartuar nga grupi prej tre ekspertëve, prof. Asoc. Dr. B.H., Mr.sc. H. P. dhe mr.sc. V. B., të cilën e .eksperti H.P. në shyrtrimin gjyqësor të dt. 03.01.2020.

Gjykatësja, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenet 73 ,74 dhe 76, par.1.5 të KPRK-ës, ka marrë për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në këtë aspekt si rrethana lehësuese për të akuzuarin B.A ka marrë për bazë pranimin e fajsisë për veprën penale e cila i vihet në barrë, sjelljen e tij gjatë gjitha fazave të procedurës, faktin se ai për herë të parë dhe të fundit ka rënë ndesh me ligjin, dhe faktin se edhe i dëmtuari-i ndjeri ka kontribuar në aksidentin në fjalë, pasi, edhe sipas zyrtarit policor, Xh. Z., i cili edhe e ka hartuar skicën nga vendi i ngjarjes, por, edhe sipas ekspertit i komunikacionit, H. P, i cili ka hartuar super ekspertizën në grup me kolegët e tij, të cilëve gjykata ua fali besimin, i ndjeri bashkë me prindërit e tij, së pari, ka lëvizur në anën e djathtë të rrugës, gjë që me Ligjin për Rregullat e Trafikut Rrugor nuk lejohet, pastaj, kanë ecur në mënyrë frontale, dmth. paralel e jo në kolonë dhe në fund, nuk kanë pasur ndonjë burim drite, ose rroba fluoreshente që do ta lajmëronin vozitësin se në atë rrugë ka këmbësorë, pasi që ka qenë errësirë, por, ata i kanë pasur rrobat me ngjyrë të mbyllur, gjë që ka kontribuar që vozitësi të mos i vërejë mirë. Nuk është kontestues fakti se në aksidentin në fjalë ka humbur jetën një i ri, për shkak të pakujdesisë së të akuzuarit, por, siç e cekëm me ë lartë, aksidentit në fjalë i ka kontribuar edhe tani i ndjeri, pendimin e thellë nga ana e të akuzuarit, kërkim falja e tij ndaj të dëmtuarit, si dhe premtimi se nuk do të përsërisë më ndonjë veprë të tillë penale, se do të jetë i kujdesshëm në komunikacion, faktin se i dëmtuari R. J ka deklaruar se me të akuzuarin janë pajtuar , ia kanë falë këtë veprim, dhe nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, ndërsa, kompensimin material e kanë realizuar më heret në kontest civil.

Sipas bindjes së Gjykatësës, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit B.A, duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegësisë së të akuzuarit, duke u bazuar në nenin 72 par. 1.5 të KPRK-së.

Gjyqtarja, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK -së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 1061/2021, më datë 10.08.2022

**Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të së njejtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.